



KUVENDI

Revistë e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 41 Tetor 2013



**RAPORTI I PROGRESIT EDHE NJË HAP TJETËR
DREJT INTEGRIMIT EVROPIAN TË KOSOVËS**

Përmbajtja

<i>E ngjeshur Axhenda Diplomatike e Kuvendi të Kosovës</i>	3
<i>Konferenca e Gjashtë e Kryetarëve të Parlamenteve të Shteteve të Ballkanit Perëndimor</i>	12
<i>Sesioni vjetor i Asamblesë Parlamentare të NATO-s</i>	14
<i>Raporti i Progresit për Kosovën</i>	17
<i>Komisioni për të Drejtat e Njeriut...</i>	20
<i>Takimi i 6-të ndërparlamentar, Parlamenti Evropian – Kosova</i>	23
<i>Dita Ndërkombëtare të Demokracisë</i>	30
<i>Dita Ndërkombëtare për Zhdukjen e Varfërisë</i>	33

Kosova hap siparin e Zgjedhjeve Lokale



E boton: Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun

E ngjeshur Axhenda Diplomatike e Kuvendi të Kosovës

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi uron kryetarin e ri të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, z. Ilir Meta



Me rastin e zgjedhjes së z. Ilir Meta, kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kryetari i Kuvendit të Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, i dërgoi një telegram urimi me këtë përmbajtje:"



I nderuar Zoti Kryetar,
Në emër të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në emrin tim personal, kam kënaqësinë dhe nderin e madh t' Ju shpreh urimet më të përzemërta dhe më të sinqerta me rastin e zgjedhjes Tuaj Kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Ju dëshiroj sukses në përmbushjen e përgjegjësive të mëdha në krye të institucionit të lartë shtetëror.

Duke vlerësuar lart marrëdhëniet e shkëlqyera midis dy vendeve tona, shpreh bindjen që ato do të thellohen dhe zgjerohen në vazhdimësi. Me këtë rast, dëshiroj edhe njëherë t'ju siguroj për vullnetin dhe dëshirën tonë për bashkëpunim.

Shfrytëzoj këtë rast t'ju shpreh mirënjohjen tonë të thellë për gjithë ndihmën që Shqipëria dhe institucionet e saj shtetërore kanë dhënë për Kosovën në këto vite vendimtare të historisë së saj.

Ju lutem, i nderuar z. Kryetar, pranoni shprehjen e konsideratës sime më të lartë

Presidenti i Republikës së Kroacisë, z. Ivo Josipović vizitë në Republikën e Kosovës



Presidentin e Kroacisë, z. Ivo Josipović, kreu një vizitë zyrtare tre ditore në Kosovë. Ai u takua me personalitetet më të larta Kosovare, ku një pritje mjaft e ngrohtë dhe miqësore Ju ofrua nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi.



Pasi falënderoi presidentin kroat për këtë vizitë zyrtare, kryekuvendari Krasniqi theksoi se Kosova dhe Kroacia po ndërtojnë marrëdhënie shumë të mira në të gjitha fushat. Një nga kontributet më të rëndësishëm midis Kosovës dhe Kroacisë mbetet bashkëpunimi i frytshëm ndërmjet dy parlamenteve tona. Parë në këtë këndvështrim, angazhimet e Kroacisë për të

ndihmuar Kosovën drejt integritit evropian janë me shumë rëndësi për Kosovën. " Ne kemi dëshirë, që në procesin e integritimeve evropiane, Kroacinë ta kemi një avokat të fuqishëm", theksoi kryekuvendari Krasniqi. Traditat e më kahershme dhe lidhjet shpirtërore midis dy popujve tanë krijojnë hapsira mjaft të mëdha për një bashkëpunim gjithnjë e më të madh.

marrëdhëniet e hershme ndërmjet Kosovës dhe Kroacisë, kreu i legjislativit të vendit, z. Krasniqi, theksoi se në Kroaci jetojnë 16 mijë shqiptarë me nënshtetësi kroate, por në të njëjtën kohë edhe në Kosovë jeton një komunitet kroat, ndaj edhe ky fakt obligon dy shtetet për forcim dhe zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit të ndërsjellë. Në Kuvendin e Kosovës, pohoi z. Krasniqi, janë të përfshira gati të gjitha komunitetet pakicë, të cilat bëjnë pjesë jo vetëm në komisionet parlamentare por edhe në Kryesi të Kuvendit. Po bëhen përpjekje që edhe komunitetet që nuk janë të përfshira në

Kushtetutë të përfshihen gjithnjë duke u bazuar në faktin se komunitetet pakicë janë ndihmesë e jo pengesë.

Në vijim kryekuvendari Krasniqi e njoftoi Presidentin e Kroacisë, z. Ivo Josipović, për procesin e zgjedhjeve lokale në vigjilje të të cilave është Kosova duke kaluar më tej edhe për procesin e bisedimeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Bisedimet, tha ai, janë gjithnjë të vështira, mirëpo Beogradi në këtë kuadër po bën edhe përpjekje për defunksionalizim të institucioneve në Kosovë.



Duke u falënderuar për pritjen, presidenti i Kroacisë, Ivo Josipović, shprehu angazhimin e Kroacisë për thellimin e bashkëpunimit të ndërsjelle, duke theksuar se marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve janë shumë të mira. Duke folur lidhur me procesin e integritimit në BE, ai tha: -"Politika jonë është integrimi i Evropës Juglindore në Bashkimin Evropian, pra edhe i Kosovës. Synimi i juaj për integrim evropian përputhet me vizionin tonë, Kosova në këtë aspekt do ta ketë përkrahjen e Kroacisë, por punën kryesore duhet ta bëni ju, sidomos në aspektin e ndërtimit të institucioneve demokratike, zbatimin e ligjeve, bërjen e reformave, ndërkaq integrimi në Evropë njëherësh do të evitojë problemet e tashme që ekzistojnë në shtetet që ende nuk janë integruar

në BE", theksoi presidenti Ivo Josipović.

Në vijimi ai tha se procesi i integritimit në BE shoqërohet me shumë sfida, shtetet që aspirojnë drejt BE-së do të kenë vështirësi, por gjithë kjo punë pastaj shpaguhet në të mirë të tyre. Ai përmendi në këtë aspekt edhe përvojën kroate drejt integritimit, duke kujtuar edhe të arriturat e Kroacisë në fuqizimin e institucioneve demokratike, avancimin e të drejtave të komuniteteve, luftën kundër korrupsionit etj. Në këtë kontekst ai vlerësoi edhe bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke shprehur besimin se këto bisedime do të sjellin efekte pozitive. Ai pastaj çmoi edhe kontributin e personaliteteve nga radhët e komunitetit shqiptar, të cilët kontribuan në zhvillimin e shoqërisë kroate.

Presidenti i Republikës së Sllovenisë,
z. Borut Pahor
vizitë në Republikën e Kosovës



Presidenti i Sllovenisë, Borut Pahor me ftesë të presidentes së Republikës së Kosovës znj. Ahtifete Jahjaga zhvilloi një takim dy ditor në Republikën e Kosovës.



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës z. Jakup Krasniqi priti Presidentin e Republikës së Sllovenisë, z. Borut Pahor

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti presidentin e Sllovenisë, Borut Pahor, me të cilin bisedoi për zhvillimet aktuale në Kosovë, për bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve dhe për mundësitë e avancimit të tij.

Duke i uruar mirëseardhjen në Kosovë presidentit Pahor, kryeparlamentari Krasniqi ka vlerësuar lartë mbështetjen e Sllovenisë për Kosovën dhe popullin e saj. Marrëdhëniet e vendosura ndërmjet dy parlamenteve të dy vendeve mike i ka vlerësuar të

shkëlqyeshme. Gjithashtu z. Krasniqi, më këtë rast ka çmuar lartë investimet ekonomike të afaristët sllovenë në Kosovë, të cilët u prijnë atyre të vendeve të tjera. Kosova dhe Sllovenia kanë mundësi të jmedha për t'i thelluar akoma më tej marrëdhëniet e bashkëpunimit të ndërsjellë në shumë fusha. Ai është shprehur i bindur se Sllovenia do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën edhe në procesin e integrimi evropiane.



Presidenti i Sllovenisë, Borut Pahor, duke shprehur kënaqësinë që ndodhet në Kosovë ka vlerësuar mjaft të arritura të mëdha të Kosovës në këto dhjetë vjetët e shkuara. Ai ka vlerësuar si një nga hapat më të rëndësishme dhe më me vlera që Kosova ka hedhur me dialogun në Bruksel ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, jo vetëm për përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve, por edhe për ndryshimin pozitiv të

statusit të Kosovës në agjendat e vendeve të BE-së. "Në procesin e integrimi evropiane Kosova ka shansin të mos bëjë gabimet e vendeve të tjera, anëtare të BE-së. Ajo mund të gjejë edhe rrugë anësore që e shkurtojnë rrugën për në BE", ka thënë Pohor.

Sllovenia do të jetë gjithnjë në përkrahje të proceseve demokratike dhe të rrugës drejt procesit të integritit në BE.

Kryeministri i Republikës së Shqipërisë zhvillon vizitën e tij të parë zyrtare në Kosovë



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës z. Jakup Krasniqi priti Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, ka pritur kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, të cilit ia ka uruar detyrën e re me përgjegjësi, në krye të ekzekutivit shqiptar. Krasniqi ka shprehur kënaqësi për zgjedhjet e lira dhe demokratike të mbajtura në Shqipëri, duke shfaqur dëshirën dhe shpresën e tij që të bëhet realitet programi i z. Rama i bërë publik në Tiranë dhe Prishtinë. Ai ka vlerësuar se janë krijuar parakushte për thellim të bashkëpunimit të përbashkët në të gjitha fushat e jetës dhe të punës.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, duke shfaqur kënaqësinë për vizitën zyrtare në Kosovë dhe për rastin që iu ka dhënë që t'iu adresohet deputetëve të Kuvendit të Kosovës, ka përkujtuar luftën e gjatë të popullit shqiptar në Shqipëri dhe në Kosovë për shtetformim.

Rama ka çmuar afirmimin ndërkombëtar të Kosovës dhe të arriturat e saj evidente. Ai e ka ripërsëritur edhe në këtë takim interesimin e tij, si kryeministër i Shqipërisë, për takime të përbashkëta në Prizren të dy qeverive dhe të përvijimit të projekteve të përbashkëta strategjike. Ai, ndërkaq, është shprehur i bindur se bisedimet me Serbinë dhe marrëveshjet e arritura në Bruksel, do të ndikojnë pozitivisht për bashkëpunim ndërshtetëror dhe më gjerë dhe se do të jenë faktor nxitës për investimin e kapitalit të huaj në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Krasniqi ka vlerësuar se dialogu dhe marrëveshjet me shtetin serb janë të domosdoshme, por ka theksuar se Beogradi zyrtar vazhdon përpjekjet për defunksionalizimin e institucioneve të Kosovës.

Seancë solemne e Kuvendit, me rastin e vizitës së kryeministrit të Shqipërisë, z. Edi Rama



Me rastin e vizitës në Kosovë të kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka mbajtur sot seancë solemne, në të cilën kreu i qeverisë shqiptare ka mbajtur një fjalë rasti.

Fillimisht, kryetari i Kuvendit, dr. Jakup Krasniqi, duke i uruar z. Rama mirëseardhje në Kosovë dhe në Kuvendin e saj, ka përgëzuar zgjedhësit shqiptarë për kulturën e lartë demokratike dhe për mbarëvajtjen e zgjedhjeve të lira, fer dhe të suksesshme. Standardet e larta të këtyre zgjedhjeve, shtoi Krasniqi, kanë dëshmuar gjithashtu pjekurinë politike, përgjegjësinë dhe seriozitetin e partive politike e të institucioneve të shtetit shqiptar.

Duke i uruar kryeministrit Rama, qeverisë që ai drejton dhe institucioneve tjera të zgjedhura, sukses të plotë në përmbushjen e objektivave gjatë mandatit të tyre, kreu i Kuvendit të Kosovës tha se vizita zyrtare që kryeministri i Shqipërisë i bën Kosovës, fill pas konstituimit të Qeverisë së re, dëshmon lidhjet e ngushta që ka Shqipëria me Kosovën dhe rëndësinë që ai u jep

marrëdhënieve midis dy shteteve tona.

"Qëllimet programatike të Qeverisë së re karshi Kosovës, të proklamuar nga vetë kryeministri Rama janë inkurajuese e shpresëdhënëse për thellimin e marrëdhënieve tona dhe për përmbajtjen e re të tyre. Përparim të dukshëm të marrëdhënieve kemi pasur edhe deri tani, por ritmi dhe dimensionin e tyre na kanë mbajtur larg nivelit të mundshëm dhe nevojave e interesave të kohës", theksoi Krasniqi në fjalën e tij, ndërsa shtoi se epoka në të cilën kemi hyrë, u ka hapur rrugë dhe perspektivë të shkëlqyer marrëdhënieve midis Shqipërisë e Kosovës, si dhe integriteteve rajonale e euroatlantike të tyre.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në adresimin e tij para deputetëve, vuri theksin tek rritja e bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve, nëpërmjet projekteve të përbashkëta. Ai i bëri apel shtetarëve të Kosovës që të forcojnë përpjekjet për zhdukjen e kufijve të padukshëm.



"Kufirin mes shteteve tona nuk e shoh si një vijë mes dy shteteve. Kufiri ishte i djeshëm, e ardhmja s'ka kufi", theksoi Rama.

Në fjalën e tij, kryeministri Rama u ndal në udhëtimin që përfaqësuesit e UÇK-së bënë aso kohe për në Rambuje, këmbënguljen që edhe ata të jenë pjesë e këtij takimi, që sipas tij bëri që të ndërrojë e ardhmja e shqiptarëve.

"Pa përfaqësuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk nisemi sot, as nesër, asnjëherë. Kështu mendojnë të gjithë, vetëm bashkë", tha profesor Rexhep Qosja, një prej anëtarëve të

delegacionit, pak para se i gjithë delegacioni bashkë me luftëtarët e lirisë, përfaqësi e miliona zemrave shqiptare me plot besim në të drejtën e madhe, qoftë edhe të vonuar, të ndërmerre në orët e fundit të shekullit të vjetër, udhëtimin që ndryshoi përgjithmonë rrugën drejt të sotmes", tha kryeministri i ri shqiptar.

Ai tha se vjen sot në Kosovë me gjithë admirimin sesi Kosova u bë protagoniste e paqes me fqinjin e saj, Serbinë.

"Vij me respektin e madh çfarë keni ditur të bëni për Kosovën në vetëm 5 vjet shtet dhe me disponimin më të plotë për të mësuar se rruga jonë është e bashkuar drejt familjes evropiane. Nuk jam këtu për vazhdimin e retorikes së dashurisë së shteti amë ndaj shtetit- bijë, por jam për themelin e një aleancë mes të barabartëve, Shqipëri-Kosovë. Retorikat nacionaliste të së shkuarës mos t'i dëgjojmë. Le të projektojmë të ardhmen. Mezi pres mbledhjen e përbashkët në Prizren dhe miratimin e agjendës së saj për të konkretizuar projektet", u shpreh Rama para ligjvënësve e të Kuvendit të Kosovës.

Duke vlerësuar punën e paraardhësit të tij Sali Berisha në projektin TAP, Rama premtoi se qeveria e tij do shkojë dhe më tej, për të bërë të mundur që një degëzim i saj të përfshijë dhe Kosovën.

Duke prekur temën e marrëdhënieve me fqinjët, kryeministri shqiptar shpallosi idenë e kthimit të Preshevës në shembullin e pakicave dhe lajtmotiv të dialogut Kosovë-Serbi. Ndërsa, duke sjellë në vëmendje çështjen çame, tha se zgjidhja do ketë në themel traktatin e bashkëpunimit me Greqinë.



"Presheva puq kufirin e tre shteteve. Këtë fakt nuk duhet të anashkalojmë, por ta kthejmë Preshevën në shembullin e pakicave. Pse te mos bëhen të drejtat e pacenuara në Preshevë dhe veriun e Kosovës lajtmotivi i parë i marrëveshjes mes Kosovës dhe Serbisë. E rinëvizoj gatishmërinë e Shqipërisë të çojmë para këtë epokë bashkë me serbët edhe të tjerët", theksoi Rama.

Për sa i takon arsimin, kreu i qeverisë shqiptare tha se nuk duhet humbur më kohë, duke shtuar se "duhet të unifikojmë sistemin arsimor, pasi skeçi i çdo shtatori që publikohej abetarja e përbashkët, do t'ia lerë vendin bashkëpunimit për arsimin".

Ai shtroi nevojën e gjetjes së rrugës së duhur për një strategji të përbashkët për bujqësinë, ku shfrytëzimi i potencialeve që ka hapësira shqiptare, me koordinimin e të dy shteteve, do të sillte shpërndarjen rajonale të prodhimit, zgjerim të rrugëve të prodhimit dhe rritje të të ardhurave nga prodhimi këtej dhe andej kufirit.

"Ne do t'i japim fund patatefobisë në rajon, që ka shkaktuar luftëra doganore në kufi. Të nxisim rritjen e prodhimit bujqësor. Janë plot rastet e mallrave të kësaj ane që kanë ngecur pa kaluar në atë anë. Jemi të gatshëm të realizojmë bashkimin doganor. E di që nuk është e lehtë, por të ngrejme një grup të përbashkët me qëllim që t'i japim një përmasë të madhe lirie dhe konkurrence biznesit shqiptar në të gjithë hapësirën shqiptare", tha Rama.

Një Forum i Përvitshëm Kombëtar në Vlorë, ishte projekti i dytë i Ramës pas idesë për mbledhjen e parë të përbashkët të dy kabineteve qeveritare, në Prizren, gjatë muajit nëntor të këtij viti.

Në fund kryeministri i Shqipërisë Edi Rama, e përmbylli fjalimin e tij me këto fjalë: "Dua ta them mu ashtu siç e tha Faik Konica siç di më bukur se askush kur foli shqip në fund të përsëritjes së vet më 7 maj 1921, përpara një grupi atdhetarësh:- mbetëm i juaji me besë."

Vizitë e kryeministrit të Republikës së Turqisë, z. Recep Tayyip Erdogan në Kosovë



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti sot në një takim kryeministrin e Republikës së Turqisë, z. Recep Tayyip Erdogan. Duke falënderuar kryekuvendarin për mikpritjen, kryeministri i Republikës së Turqisë, z. Recep Tayyip Erdogan, foli për rëndësinë dhe nxitjen që do t' i japë Aeroporti i Prishtinës lëvizjes së qytetarëve , por edhe zhvillimeve të tjera ndërmjet dy vendeve."Këshillojmë investitorët turq që të investojnë në Kosovë në të gjithë lëmenjtë. Marrëdhëniet ndërmjet Turqisë dhe Kosovës do të thellohen edhe më. Në e ndjejmë për detyrë që të kemi marrëdhënie sa më të mira me Kosovën", theksoi kryeministri Erdogan. Ai në vijim foli edhe për rëndësinë që i jep Turqia thellimit të bashkëpunimit ndërparlamentar me të gjitha shtetet e Ballkanit, ndërsa një vështrim të gjerë i bëri edhe angazhimit

që bën Turqia, që Kosovën ta njohin sa më shumë shtete , si nga bashkësia e shteteve islamike, ashtu edhe nga shtetet tjera.

Kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, pasi përshëndeti kryeministrin dhe delegacionin që e shoqëronte, vlerësoi lart marrëdhëniet shumë të mira ndërmjet Parlamentit të Madh të Turqisë dhe Kuvendit të Kosovës. Këtë e tregon edhe fakti i shumë vizitave reciproke të parlamentarëve turq dhe atyre nga Kosova. Në këtë funksion është edhe kjo vizitë . Në vijim kryetari Krasniqi vlerësoi edhe të arriturat e mëdha që po arrin Turqia në zhvillimin ekonomik të saj. Turqia vazhdon të jetë prezente në shumë fusha në Kosovë, si: në biznes, arsim,shëndetësi etj. Bashkëbiseduesit ishin të një mendjeje se marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Turqisë po forcohen në të gjithë lëmenjtë.

Konferenca e Gjashtë e Kryetarëve të Parlamenteve të Shteteve të Ballkanit Perëndimor

Në Budapest po zhvillon punimet Konferenca e Gjashtë e Kryetarëve të Parlamenteve të Shteteve të Ballkanit Perëndimor, në të cilën po marrin pjesë kryetarë nga vendet e rajonit.



Darkë pune e Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi dhe Kryetari e Kuvendit të Shqipërisë, Ilir Meta.

Gjatë ditës së parë kryetari Krasniqi ka zhvilluar takime të veçanta me –

Kryetarin e Kuvendit të Hungarisë, Laszlo Kover,
Kryetarin e Parlamentit të Kroacisë, Josip Leko,
Kryetarin e Kuvendit të Maqedonisë, Trajko Veljanoski
Nënkryetarin e Kuvendit të Malit të Zi, Branko Raduloviq.

Në të gjitha këto takime u bisedua për bashkëpunimin rajonal, veçanërisht në fushën parlamentare, si dhe për aspiratat e përbashkëta drejt integritimeve evropiane.

Fjalë e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, dr. Jakup Krasniqi në Konferencën e Gjashtë të Kryetarëve të Parlamenteve të Shteteve të Ballkanit Perëndimor

Integrimi në Bashkimin Evropian: rezultatet dhe aspiratat

I nderuar zoti László Kövér, kryetar i Parlamentit të Hungarisë
Të nderuar kryetarë dhe përfaqësues të parlamenteve kombëtare
Zonja dhe zotërinj

Fillimisht dëshiroj të shpreh kënaqësinë time për prezencën në këtë Konferencë të përfaqësuesve të lartë të vendeve e popujve të rajonit tonë dhe t'i shpreh mirënjohjen e sinqertë organizatorit të saj, kryetarit të Parlamentit të Hungarisë z. László Kövér, i cili na bashkoi edhe njëherë rreth një interesi të madh dhe të përbashkët, atij të integritimit evropian.

Interesi ynë i përbashkët është integrimi rajonal në Bashkimin Evropian. Prej këtu rezulton edhe nevoja e një bashkëpunimi e koordinimi për të shkurtuar rrugën drejt këtij qëllimi madhor. Në qoftë se do të këmbëjmë përvojat tona të mira, në qoftë se do ta mbështesim njëri-tjetrin, integrimi ynë evropian do të jetë më i suksesshëm dhe më i afërt.

Republika e Kosovës është tërësisht e përkushtuar për zbatimin e agjendës evropiane. Nga Konferenca e kaluar këtu në Budapest, tash e dy vjet më parë, në vendin tim kanë ndodhur shumë ndryshime përparimi dhe janë bërë hapa të rëndësishëm drejt integritit evropian. Rruga e kaluar deri tash dhe perspektiva e veprimeve të ardhshme janë përcaktuar nga tre faktorë bazë: vullneti i gjerë qytetar për Kosovën evropiane, angazhimi i fuqishëm institucional dhe përkrahja e Bashkimit Evropian për të shtyrë përpara proceset integruese në Ballkanin Perëndimor në përgjithësi dhe në Kosovë, në veçanti. Qeveria jonë tash sa vite zbaton Planin e Veprimit për Zbatimin e Partneritetit Evropian, i cili azhurnohet në vijimësi, sipas rekomandimeve të Komisionit Evropian në raportet vjetore të progresit. Ajo ka miratuar edhe Planin për Integrim Evropian dhe ka ngritur një varg mekanizmash implementimi të niveleve të ndryshme. Kuvendi i Kosovës ka një Komision të veçantë për integritime evropiane, i cili ka përgatitur Strategjinë e integritit dhe koordinon veprimet e zbatimit të saj.

Në Presidencën e Kosovës, ndërkaq është themeluar Këshilli Nacional për Integrim Evropian, i cili i kontribuon koordinimit politik të institucioneve qendrore të shtetit, komunave, partive politike, shoqërisë civile, institucioneve akademike, komunitetit të biznesit etj.

Në tetor të vitit 2012 Komisioni Evropian ka publikuar Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit në mes të Bashkimit Evropian dhe Kosovës. Dokumenti përshkruan progresin që Kosova ka arritur në tre vitet e fundit, kurse Komisioni dhe Këshilli Evropian para pak muajsh kanë vlerësuar se Kosova është e gatshme për të filluar negociimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian. Pritet që kjo Marrëveshje të arrihet në pranverën e vitit të ardhshëm, për t'u hapur rruga e aplikimit të Kosovës për statusin e kandidatit.

Në kuadër të këtyre proceseve integruese është edhe dialogu i gjatë dhe i vështirë midis Kosovës dhe Serbisë, i lehtësuar dhe mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe baronesha Eshton. Janë arritur një varg marrëveshjesh, të cilat synojnë normalizimin e raporteve midis këtyre dy vendeve. Dialogu dhe marrëveshjet janë mënyra më e mirë, madje e vetme për të zgjidhur çështjet e hapura bilaterale, për normalizimin e marrëdhënieve dhe për stabilizimin e rajonit tonë, të trazuar në shekuj. Ky proces është në funksion të integritit evropian dhe një kusht sine qua non, që presupozon zgjidhjen e të gjitha kontesteve midis vendeve dhe popujve aspirues, para aderimit në BE dhe për më tepër që zgjidhja të bëhet në frymën e filozofisë politike dhe parimeve evropiane, me mjete paqësore dhe në mirëkuptim, drejtësi e respekt të ndërsjellë. Në këtë frymë dhe sipas këtyre parimeve ne e kemi kuptuar dialogun me Serbinë, një dialog të sigurtë, me dobi të përbashkët, që i kontribuon vendosjes së marrëdhënieve normale midis dy vendeve dhe popujve tanë, bashkëpunimit dhe marrëveshjeve, pa dëmtuar njëri-tjetrin. Vetëm marrëveshjet e drejta e qëllimmira, mund të jenë të qëndrueshme dhe në të mirë, jo vetëm të vendeve që i arrijnë ato, por edhe të stabilitetit e paqes në rajonin e kontinentin tonë.

Ne i gëzohemi përparimit të çdo vendi të Ballkanit Perëndimor drejt integritit, sepse vetëm integrimi i të gjitha këtyre vendeve në Bashkimin Evropian, sjell stabilitetin e plotë të rajonit, bashkëpunimin e mirëfilltë dhe paqen e zhvillimin e gjithmbarshëm.

Rruga drejt Bashkimit Evropian kalon nëpërmjet reformave të gjithanshme. Ato shpeshherë janë të vështira dhe me dhembje, prandaj kërkojnë lidhshmëri të fortë dhe guxim në vendimmarrje, sepse efektet imediate të tyre mund të dëmtojnë interesat efemere, kurse dobia është në hapat vijues, në afat më të gjatë dhe përtej mandateve aktuale të qeverive në pushtet. Proceset integruese janë më shumë interes i së ardhmes se sa i të sotmes emergjente. Ne duhet të kemi vizionin, vullnetin, qëllimin dhe vendosmërinë të shikojmë më larg në të ardhmen tonë më të mirë e të përbashkët. Uroj që kjo Konferencë e radhës t'i shërbejë përparimit tonë në rrugën drejt Bashkimit Evropian, forcimit të paqes dhe të bashkëpunimit të gjithanshëm rajonal. Faleminderit.

Sesioni vjetor i Asamblesë Parlamentare të NATO-s



Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Xhavit Hailiti, merr pjesë në sesionin vjetor të punimeve të Asamblesë Parlamentare të NATO-s



Në Dubrovnik të Kroacisë më 14.10.2013 zhvilloi punimet sesioni vjetor i Asamblesë Parlamentare të NATO-s. Në këtë sesion po merr pjesë edhe një delegacion i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga nënkryetari Xhavit Hailiti. "Marrëveshja Beograd - Prishtinë paraqet një hap tjetër të rëndësishëm në normalizimin e raporteve në mes të këtyre dy vendeve. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje duhet të vazhdojë. NATO-ja dhe KFOR-i kanë një rol kyç në zbatimin e kësaj marrëveshjeje", ka thënë sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen gjatë fjalimit të tij. Qoftë në Kosovë, Libi apo në Afganistan forcat

ushtarake të udhëhequra nga NATO-ja me aftësinë e tyre kanë mundësuar t'i jepet fund dhunës dhe gjakderdhjes. Forcat e NATO-s, sipas tij, kanë kontribuar në stabilitetin e këtyre vendeve.

"Gjatë dekadës së fundit, Kroacia ka ecur përmes dyerve të hapura të NATO-s, siç kanë vepruar edhe Shqipëria dhe Sllovenia", ka thënë Rasmussen.

Në këtë kontekst, ai ka thënë se dyert e NATO-s janë të hapura edhe për Bosnjë - Hercegovinën, Malin e Zi dhe ish-Republika Jugosllave të Maqedonisë, nëse ato demonstronjë një vendosmëri të re për të tejkaluar mosmarrëveshjet e vjetra.

Fjala e Nënkryetarit të Kuvendit të Kosovës, z. Xhavit Hailiti, mbajtur në sesionin vjetor të Asamblesë Parlamentare të NATO-s

I nderuar drejtues i seancës!
Të nderuar pjesëmarrës!
Ju falënderoj që më mundësuat të flas sot para Jush dhe besoj se do të më lejoni e mirëkuptoni të falënderoj njëherësh, edhe organizatorët e këtij takimi, që ftuan zyrtarisht përfaqësuesin e Republikës së Kosovës në të. Pjesmarrja ime mes jush më jep rastin të shfaq konsideratat dhe vlerësimet për angazhimin dhe kontributet e NATO-s dhe BE-së për krijimin dhe konsolidimin e shtetit dhe të ndërtimit të demokracisë në Republikën e Kosovës, pavarësia e së cilës, deri sot, është njohur zyrtarisht

nga 105 anëtarë të OKB-së, po që ende nuk njihet formalisht si anëtare e OKB-së. Ky status aktual ndërkombëtar i shtetit më të ri evropjan, që shpresoj dhe besoj se do të ndryshoj së shpejti, më detyron të parashtroj në fjalën time disa konsiderata.

Së pari, dua të vë në dukje mendësinë dhe qëndrimin e bashkëkombësve të mi dhe të shtetit të Kosovës ndaj NATO-s dhe BE-së, që kanë një specifikë të ndjeshme në raport me të gjithë shtetet e tjera të përfaqësuar në këtë takim. Si rrjedhojë e këtij dallimi është edhe vlerësimi më sipëror i yni për rolin dhe kontributin e



NATO-s dhe BE-së për stabilizimin e Ballkanit Perëndimor dhe integrimin gradual të tij në institucionet Euro-Atlantike. Këtë konsideratë e kam krijuar nga rrjedha e ngjarjeve dhe nga zhvillimet e deritanishme politiko-sociale në Republikën e Kosovës dhe në raportet e shtetit tonë me fqinjët, sidomos me Serbinë. Pa angazhimin disiplinës të faktorit ndërkombëtar të OKB-së, BE-së, NATO-s, EULEX-it, Kosova nuk do ishte sot bashkëpjesëmarrëse në këtë takim të organizuar nga Asambleja Parlamentare e NATO-s.

Shqetësimi, në fokus të këtij takimi : " Normalizimi i plotë i rajonit nuk ka përfunduar ende", është shqetësim realist, sepse është i dukshëm dhe i prekshëm.

Në bashkësinë tonë ka mungesa të normalitetit etnik, social dhe politik në rreth gjysmën e shteteve.

Tri pjesmarrës në këtë takim, Bosnjë-Herzegovina, Kosova dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë mund ta deshmojnë këtë përfundim.

Gjysma e anëtarëve të Ballkanit Perëndimor janë në lidhje të drejtpërdrejta me struktura të NATO-s, ndjejnë peshën, kontributin dhe pushtetin e tyre dhe natyrshëm kanë mësuar dhe vlerësojnë këtë kontribut. Nga raporti i përgatitur nga reporterët e Asamblesë Parlamentare të NATO-s, për Kosovën, kemi krijuar bindjen jo vetëm për objektivitetin dhe vërtetësinë e problematikës së parashtruar në të, por dhe për dashamirësinë realiste të

interpretimit të tij. Frymën disi të theksuar kritike për dukuri politike-sociale dhe etnike, që janë të pranishme edhe në zhvillimet e fundit në vendin tonë e vlerësojmë si nxitëse për shpejtimin e ritmit të progresit politik për t'i hapur sa më parë negociatat me MSA-në, si dhe për të realizuar sa më shpejt premtimin e njohur publik të Qeverisë së Kosovës për liberalizimin e vizave të qytetarëve kosovarë në zonën Shengen.

Nga problematika e parashtruar në raportin e Asamblesë Parlamentare të NATO-s dua të veçoj dy çështje:
Së pari: Zvogëlimi i pranisë ndërkombëtare në Kosovë në vitet e fundit.

Qysh nga shpallja e Pavarësisë është reduktuar gati tri herë kontigjenti i KFOR-it në Kosovë. Roli i UMNİK-ut në Kosovë është reduktuar thellësisht që prej vitit 2008. EULEX-i është i pranishëm dhe veprues ndonëse atakohet nga segmente të serbëve dhe jo-serbëve në Kosovë. Megjithatë, prania vepruese e faktorit ndërkombëtar në Kosovë vazhdon të jetë e nevojshme. BE-ja ka qënë shumë e përkushtuar dhe e

vëmendshme për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi. Në përkujdesjen vigjiluese të Brukselit dhe posacërisht të Baroneshës Ashton, u arrit marrëveshja historike e 19 prillit mes dy shteteve. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje, sipas deklaratës të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Z. Rasmussen do të mbështetet nga KFOR-i, "me të gjitha mundësitë që ka, brënda mandatit të vet".

Së dyti: Shqetësimet e faktorit ndërkombëtar për zhvillimin e zgjedhjeve të 3 nëntorit për pushtetin vendor në Republikën e Kosovës në parametrat e parashikuara në marrëveshjen e 19 prillit.

Zhvillimi i afërt i këtyre zgjedhjeve, që vlerësohen ndërkombëtarisht si " Test serioz për kornizën e re administrative të Kosovës" sipas marrëveshjes së prillit, duket sikur është shndërruar në një "Mollë sherri" mes dy shteteve. Shfaqje sporadike të nacionalizmit, rezistenca e segmenteve të ndryshme politike në të dy shtetet, keqkuptimi me ose padashje i deklarimeve publike të pushtetarëve në Prishtinë dhe Beograd e detyruan Baroneshën Ashton, të thërrasë dhe ballafaqoj në Bruksel kryeministrat e të dy vendeve. Përfundimet e këtij takimi mendoj se janë një dëshmi dhe garanci e zhvillimit të zgjedhjeve të pritshme. Aktualisht Kosova është gati në gjysëm të fushatës

dhe ecurija e deritashme e saj, normaliteti, mungesa e konfliktualitetit janë tregues pozitiv për përballjen e shtetit të Kosovës me zgjedhjet, të cilësuar dhe vlerësuar nga ndërkombëtarët si " test serioz për kornizën e re administrative të Kosovës", por dukshëm, edhe si kartë kredibiliteti ndaj Kosovës prej NATO-s dhe gjithë miqëve dhe mbështetësve tanë n d e r k o m b ë t a r e . Jemi ende në rrugë për të nënshkruar MSA-në. Jemi ende larg për të qënë anëtarë të NATO-s. Sidoqoftë më dhatë mundësinë të flas para jush, dhe për këtë, si përfaqësues i ftuar i Republikës së Kosovës, ju falenderoj!, theksoi z.Xhavit Haliti.

Raporti i Progresit për Kosovën - një hap tjetër drejt integritimit Evropian

Samuel Zhbogar i dorëzoi kryetarit Krasniqi Raportin e Progresit për Kosovën
Raporti do të jetë një dokument orientues për punën e Kuvendit



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti sot në takim përfaqësuesin special të Bashkimit Evropian në Kosovë, Samuel Zhbogar, nga i cili pranoi Raportin e Progresit për Kosovën.

Duke i dorëzuar kryetarit Krasniqi raportin, përfaqësuesi evropian në Kosovë tha se ai përmban dy qëllime kryesore: shikimin prapa për punën që është bërë, si dhe objektivat për të ardhmen, në të cilat duhet të fokusohet Kosova.

Zhbogar e konsideroi raportin pozitiv, pasi ai pasqyron të arriturat e Kosovës gjatë periudhës raportuese dhe identifikon sfidat për të ardhmen. Në këtë drejtim, u vlerësua pozitivisht edhe puna e Kuvendit të Kosovës.

Duke e falënderuar përfaqësuesin e BE-së, për raportin, kryeparlamentari Krasniqi tha se ai do të studiohet hollësisht dhe do të nxirren detyrat përkatëse për Kuvendin në tërësi, ndërsa

komisionet do t'i hartojnë, sipas praktikës së deritashme, planet e tyre të veprimit.

Kryetari Krasniqi tha se Kuvendi mbetet i përkushtuar në implementimin e objektivave të tij, në procesin e integritimeve evropiane për Kosovën.

“Raporti i Progresit do të jetë një dokument orientues për punën e Kuvendit gjatë periudhës në vazhdim”, theksoi kreu i legjislativit të vendit, ndërsa shfaqti shpresën se raporti i ardhshëm do të jetë edhe më pozitiv për Kuvendin, mbi bazën e punës së tij.

Zhbogar u dorëzoi nga një kopje të Raportit të Progresit përfaqësuesve të LDK-së,
Vetëvendosjes e AAK-së



Përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian në Kosovë, Samuel Zhbogar, iu ka dorëzuar nga një kopje të Raportit të Progresit për Kosovën për vitin 2013, përfaqësuesve të tri subjekteve opozitare në Kuvendin e Kosovës, Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lëvizjes Vetëvendosje dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, gjegjësisht, deputetëve: Teuta Sahatqija (LDK), Albin Kurti (VV) dhe Blerim Shala (AAK).

Në takim, shefi i Zyrës së BE-së në Prishtinë i bëri një prezantim raportit dhe shpalosi pikat kryesore në të cilat ai fokusohet. Zhbogar u ndal në zhvillimet kryesore nëpër të cilat ka kaluar Kosova gjatë periudhës njëvjeçare, të cilat trajtohen në këtë raport, si dhe në sfidat dhe objektivat e saj për të ardhmen.

Sahatqija, Kurti e Shala, ndërkaq, prezantuan qëndrimet e subjekteve të tyre politike përkitazi me vlerësimet e bëra në raport.

Danimarka një partner serioz për Kosovën

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi priti Komisionin për Çështje Evropiane të Parlamentit të Danimarkës

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, ka pritur në një takim Komisionin për çështje Evropiane të Parlamentit të Danimarkës, të kryesuar nga Eva Kjer Hansen, kryetare e Komitetit për Çështje të BE-së. Duke vlerësuar lartë bashkëpunimin ndërmjet Kosovës dhe Danimarkës, kryetari Krasniqi shprehu falënderimin për ndihmën që

shteti danez i ka dhënë Kosovës në rrugën e saj të lirisë, të ndërtimit të institucioneve e zhvillimit të demokracisë.

Në vazhdim, kryeparlamentari dha një pasqyrë të punës së Kuvendit e të përbërjes së tij, me theks të veçantë, të përfaqësimit të komuniteteve pakicë.



Në këtë funksion, kryetari i Kuvendit përmendi edhe të drejtat që këto komunitete, veçanërisht ai serb, gëzojnë edhe në sfera të tjera të jetës politike e shoqërore të vendit tonë, të kodifikuara në ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës.

Duke u përgjigjur në pyetjet e deputetes daneze, Hansen, lidhur me situatën aktuale në Kosovë dhe sfidat me të cilat ajo po përballë, kryetari Krasniqi përmendi nevojën për vendosjen e rendit e të ligjit në gjithë territorin e Kosovës, rritjen e

mbikëqyrjes parlamentare ndaj ekzekutivit dhe institucioneve të tjera të pavarura, si dhe zhvillimin e ekonomisë e zvogëlimin e papunësisë. Deputetët nga Danimarka i interesuan edhe për procesin e zgjedhjeve lokale dhe pritjet për daljen e qytetarëve në to. Kryetari Krasniqi e konsideroi me rëndësi që këto zgjedhje të jenë të lira dhe demokratike, si dhe daljen e një numri sa më të madh të serbëve nga i gjithë territori i Kosovës.

Komisioni për Integritime Evropiane i Kuvendit të Kosovës priti Komisionin për Çështje Evropiane të Parlamentit të Danimarkës

Takimin e dytë, pas atij me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Delegacioni i Parlamentit të Danimarkës, i kryesuar nga znj. Eva Kjer Hansen, kryetare e Komitetit për Çështje Evropiane të këtij Parlamentit, e ka zhvilluar me anëtarët e Komisionit për Integritime Evropiane të Kuvendit të Kosovës.

Kryetari i Komisionit për Integritime

Evropiane, Lutfi Haziri ka falënderuar Danimarkën për mbështetjen e vazhdueshme të Kosovës dhe për njohjen e shpejtë të vendit tonë.

Ai, shprehu interesin për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy parlamenteve, sidomos për njohjen e përvojave të shkëlqyera daneze për mbikëqyrjen e Qeverisë.



«Parlamenti i Danimarkës është parlamenti më i fuqishëm i Evropës, për sa i përket mbikëqyrjes së ekzekutivit, ndërkohë që Kuvendi i Kosovës, si shumica e parlamenteve të rajonit tonë, vlerësohen si më të paefektshmet në planin e mbikëqyrjes së qeverive", ka theksuar Haziri.

Kuvendarët e Kosovës, pjesëmarrës në këtë takim, kanë kërkuar mbështetjen e shtetit skandinav për

Kosovën, sidomos në procesin e stabilizim-asocimit dhe të liberalizimit të vizave.

Kryetarja e delegacionit znj. Eva Kjer Hansen, ka shprehur kënaqësinë që ndodhet në Kosovë, në kuadër të një vizite rajonale të anëtarëve të Komisionit, të cilin e udhëheq. Ajo ka vlerësuar të arriturat e Kosovës në

vitet e shkuara, ndërkajë është interesuar për sfidat me të cilat ballafaqohet vendi. Duke pohuar përvojën e gjatë (40 vjeçare) të komisionit për mbikëqyrjen e Qeverisë, Hansen ka shprehur gatishmërinë komisionit danez që Kuvendi i Kosovës, komisionet parlamentare dhe stafi i Administratës së Kuvendit, të njihen me përvojat daneze të mbikëqyrjes.

Anëtarët e delegacionit parlamentar danez kanë shtruar pyetje të ndryshme për sa i përket miratimit të ligjeve dhe punës së Komisionit për Integritime Evropiane për harmonizimin e legjislacionit me atë të vendeve të BE-së, të cilave u janë përgjigjur parlamentarët e Kosovës.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut... takim me Komisionin për çështje Evropiane të Parlamentit të Danimarkës



Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga Suzan Novobërdali, zhviloj një takim me Komisionin për çështje Evropiane të Parlamentit të Danimarkës, të kryesuar nga znj. Eva Kjer Hansen, kryetare e Komitetit për Çështje të BE-së.

Znj. Novobërdali foli për fushëveprimtarinë e këtij Komisioni, duke theksuar se në këtë Komision nuk ka ndonjë ndarje pozitë-opozitë, pasi të gjithë anëtarët, (nga 9, tetë janë femra), janë të vetëdijshëm për rëndësinë që kanë fushat që përfshin ky komision. Kosova ka hedhur një hap të madh për të drejtat dhe liritë e komuniteteve pasi ato u garantohen me kushtetutë. Sigurimi i vendeve të veçanta në përbërjen e Kuvendit, kujdesi ndaj strukturës gjinore, janë fryt i kësaj sigurie dhe kjo po shfaqet gjithnjë e më shumë me numrin e madh të femrave deputete.

Dymbëdhjetë deputete kanë fituar këtë të drejtë mbi bazën e votave të drejtpërdrejta, që i kanë marrë në procesin e votimit në zgjedhjet e fundit parlamentare, theksoi znj. Novobërdali.

Një plagë e rëndë, për Kosovën është problemi i të pagjeturve, sidomos për vendndodhjen e viktimave, kjo për faktin se Serbia nuk bën përpjekje të duhura për zbulimin e varrezave masive, megjithëse ato i di. Madje, ka raste të rënda si ai i Rashkës, ku dihet se ekziston një varrezë masive, ndërsa përmbi të është ndërtuar një ndërtesë.

Kosova ka interes për përvojën sllovae drejt integritit evropian

Kryekuvendari Krasniqi priti një delegacion nga Parlamenti i Sllovakisë, kryesuar nga z. Ivan Stefanec



Eksperiencia gjatë rrugës drejt integritit evropian, ishte temë thelbësore e takimit të kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, me një delegacion nga Parlamenti i Sllovakisë, kryesuar nga z. Ivan Stefanec. Kryesuesi i delegacionit, z. Ivan Stefanec, pasi e njoftoi kryetarin me përbërjen e delegacionit, theksoi nevojën e përmirësimit të bashkëpunimit ndërmjet dy parlamenteve. “Është me interes që Sllovakia dhe Kosova, si dhe parlamentet përkatëse të bashkëpunojnë ndërmjet vete. Integrimi ynë nuk ishte i lehtë. Na kujtohet se sa të nevojshëm ishin miqtë në rrugëtimin tonë drejt Bashkimit Evropian. Gjatë këtij procesi ne njëkohësisht vendosëm edhe standarde

evropiane”, theksoi në fjalën e tij z. Stefanec. Kreu legjislativ të vendit, z. Krasniqi pasi shprehu kënaqësinë për këtë takim, theksoi se vizitat vendosin themele të mira për bashkëpunim ndërmjet dy parlamenteve. Në këtë frymë, bashkëpunimi po hyn në rrugë të mbarë. Kosova ka çfarë të mësojë nga përvoja sllovae drejt integritit evropian. “Vendi ynë ka ligje të standardeve evropiane, ndërsa i kushtohet rëndësi edhe të drejtave të njeriut. Aktualisht Kosova është e angazhuar në dy procese: në atë të bisedimeve me Serbinë, si dhe në procesin e zgjedhjeve lokale që do të mbahen së shpejti”, u shpreh kryekuvendari Krasniqi.

Dy popujt me histori të ngjashme duhet të kontaktojnë dhe të njihen mes vete.

Sllovakia të ndjekë shembullin e 23 vendeve të tjera të BE-së dhe ta njohë Kosovën.

Delegacioni parlamentar i Sllovakisë, i kryesuar nga Ivan Stefanec, në përbërje të të cilit ishin deputetë nga të gjitha grupet politike të Parlamentit sllovak, është pritur nga anëtarët e dy komisioneve parlamentare të Kuvendit të Kosovës: Komisionit për Punë të Jashtme dhe të atij për Integritim Evropian.

Kryesuesi i delegacionit parlamentar nga Sllovakia, Ivan Stefanec, duke shprehur kënaqësinë për këtë vizitë në Kosovë, ka pohuar se ka për objekt përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet dy parlamenteve, të cilat doemos do të reflektojnë pozitivisht edhe për marrëdhëniet e mira ndërmjet dy vendeve. Duke përkujtuar rrugën shtetformuese të Sllovakisë dhe të anëtarësimit të saj në BE dhe në NATO, ai ka

theksuar se vendi i tij mbështet rrugën evropiane të Kosovës, si dhe të vendeve të tjera, duke shtuar se Ballkani Perëndimor mbetet prioritet i politikës së jashtme të vendit të tij. Ai është shprehur i bindur se bisedimet me Beogradin në Bruksel do të reflektohen pozitivisht për shtensionimin e raporteve në këtë pjesë të Evropës dhe do të reflektojnë pozitivisht edhe për perspektiven e të gjitha vendeve të rajonit.

Edhe parlamentarët e tjerë sllovakë janë shprehur të bindur për rrugën evropiane të Kosovës, si dhe kanë vlerësuar pasuritë natyrore të Kosovës, e veçmas potencialin njerëzor të vendit tonë, me një rini të shumtë e të shëndetshme si rrallëkund. Ata, ndërkaq, kanë shtruar pyetje të shumta për perspektivat zhvillimore të Kosovës, për integritimin e komuniteteve pakicë, sidomos për të

zhvendosurit serbë, siç janë shprehur ata “ të 200 mijë serbëve nga Kosova, nga të cilët 40 mijë nga Prishtina”, si dhe për rezultatet e kthimit të serbëve në pronat e tyre.

Duke u uruar mirëseardhje në Kosovë miqve sllovakë, Albin Kurti, i cili e ka drejtuar takimin, ka përkujtuar se në pesë vjet e gjysmë të pavarësisë së Kosovës, vendin tonë e kanë njohur mbi gjysma e vendeve anëtare të OKB-së dhe 23 vende të BE-së. “Kosova promovon dhe kultivon marrëdhënie të mira me të gjitha vendet e botës, e

veçanërisht me vendet e BE-së, andaj shpresojmë se edhe Sllovakia, duke e ndjekur shembullin e tyre, do ta njohë Kosovën, duke hapur kështu perspektiva për komunikime dhe marrëdhënie në shumë fusha të jetës, në interes të përbashkët për të dy vendet dhe popujt e tyre”, ka theksuar Kurti. Ai në vazhdim ka folur për rrugën e shtetformuese të Kosovës , por edhe për sfidat me të cilat ballafaqohet vendi ynë, si : zhvillimi i pamjaftueshëm ekonomik, papunësia në rritje, obstrukcionet e strukturave serbe në Kosovë dhe korrupsioni enorm.



Nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti, ka theksuar se shqiptarët shpeshherë akuzohen gabimisht se e kanë shkatërruar Jugosllavinë. “Jugosllavinë e kanë shkatërruar ata që e kanë formuar: serbët, kroatët dhe sllovenët”. Ai ndërkaq ka pohuar se serbë të shumtë janë larguar në përfundim të luftës, pjesa më e madhe e të cilëve i kanë shitur pronat në Kosovë, janë integruar në vendbanime të ndryshme të Serbisë dhe se shumica e tyre nuk dëshirojnë të kthehen në Kosovën e varfër. Ai ka pohuar se nuk po kthehen madje as serbët, të cilëve Qeveria e Kosovës u ka ndërtuar shtëpi të reja.

“Asnjëherë gjatë historisë në Kosovë nuk kanë jetuar 200 mijë serbë, dhe nuk kanë jetuar asnjëherë 40 mijë serbë në Prishtinë, siç trumbeton propaganda e fuqishme e Beogradit”, ka theksuar nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti. Duke pohuar se shifrat janë të ekzagjeruar, ai ka mbajtur qëndrim se të shpërngulur nuk mund të konsiderohen pjesëtarët e forcave militare dhe paramilitare serbe, të cilët kanë ushtruar gjenocid në Kosovë, e që janë kthyer të mundur në shtëpitë e tyre.

Nënkryetari nga radhët e komuniteteve të tjera pakicë, Enis Kervan, duke përkujtuar se komunitetet pakicë që përfaqëson në Kuvend numerikisht bëjnë më shumë se serbët që jetojnë në Kosovë, ka theksuar privilegjin dhe mbipërfaqësimin e serbëve në institucionet e Kosovës.

Edhe deputetja nga radhët e komunitetit boshnjak, Emilia Rexhepi ka folur për integrimin e komunitetit të saj dhe të komuniteteve të tjera pakicë, ndërkohë që serbët janë integruar fare pak, megjithëse gëzojnë privilegjet më të mëdha.

Deputetja Vjosa Osmani, ndërkaq, ka folur për rëndësinë që i jep Kuvendi i Kosovës harmonizimit të ligjeve që i miraton me legjislacionin e vendeve të BE-së. Parlamentarët e Kosovës kanë pohuar se janë të mirëpritura dhe të sigurt investimet sllovaqe në ekonominë tonë. Të gjithë deputetët kosovarë që kanë folur në takim kanë pohuar se ekziston konsensus i plotë nacional dhe partiak për integrimin evropian të Kosovës.

Deputetët e të dyja delegacioneve i kanë dhënë mbështetje idesë së parlamentarëve sllovakë për krijimin e grupit joformal të miqësisë ndërmjet dy parlamenteve.

Takimi i 6-të ndërparlamentar, Parlamenti Evropian – Kosova

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti delegacionin e Parlamentit Evropian, të udhëhequr nga z. Eduard Kukan, i cili ndodhet në Kosovë në kuadër të takimit të 6-të ndërparlamentar, Parlamenti Evropian – Kosova.



Zhvilloi punimet takimi dy ditor ndërparlamentar: Parlamenti Evropian – Kosova

Në ambientet e Kuvendit të Kosovës filloi punimet dyditore takimi i gjashtë ndërparlamentar: Parlamenti Evropian - Kosova. Delegacioni i Parlamentit Evropian kryesohet nga z. Eduard Kukan, kryesues i delegacionit për marrëdhënie me Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Serbinë, Malin e Zi dhe Kosovën, kurse delegacionin e Kosovës e kryeson kryetari i Kuvendit të Kosovës, dr. Jakup Krasniqi.

Duke e hapur takimin, kryeparlamentari Krasniqi

tha se më 14 dhe 15 mars të vitit të kaluar, në Strasburg është mbajtur takimi i 5-të ndërparlamentar: Parlamenti Evropian - Kosova, në të cilin janë shqyrtuar dhe debatuar në mënyrë konstruktive tema të rëndësishme të aktualitetit. Ndërsa sot, po takohemi për të gjashtën herë, duke pasur para vetes një agjendë mjaft të ngjeshur, me tema të mprehta, për zhvillimet nëpër të cilat po kalon Kosova, si dhe për perspektivën evropiane të saj.



Kryesuesi i delegacionit për marrëdhënie me Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Serbinë, Malin e Zi dhe Kosovën, Eduard Kukan, në fjalën e tij të hapjes, tha se ky takim ndodh në një moment shumë të rëndësishëm për Kosovën, si në aspektin e brendshëm, ashtu edhe për perspektivën evropiane të saj. Ai tha se prania e delegacionit të PE-së sot në Kosovë, duhet të shihet si një shenjë mbështetjeje

për punën e institucioneve të Kosovës në procesin e integritit dhe përpjekjet e tyre për të formësuar Kosovën në rajon dhe Evropë.

"Kosova ka kaluar procese të rëndësishme gjatë periudhës së shkuar. Kemi parë zhvillime pozitive në dialogun me Beogradin, progres në agjendën evropiane, si dhe disa vendime të rëndësishme në politikën e brendshme të vendit", tha Kukan.

Duke cituar Raportin e Progresit për Kosovën, ai tha se perspektiva evropiane e Kosovës ka ecur në hapa shumë të rëndësishëm dhe i inkurajoi udhëheqësit e Kosovës që të ecin përpara në këtë proces.

Në vazhdim, ai u ndal edhe në sfidat me të cilat përballlet Kosova dhe punët që duhet të kryhen. Në këtë drejtim, ai tha se shteti i së drejtës mbetet gjithmonë thelbi i reformave që duhet të ndërmarrë Kosova në të ardhmen, sistemi gjyqësor duhet të jetë efikas, llogaridhënës, i paanshëm dhe i pavarur, krimi i organizuar duhet luftuar dhe shfarosur, ndërsa lufta kundër korrupsionit duhet të jetë e besueshme dhe e vazhdueshme.

"Këto janë elementet të cilat janë të rëndësishme për të pasur një shoqëri të lirë e të hapur, si dhe për besimin e saj në sistemin demokratik", theksoi Eduard Kukan.

Zgjedhjet lokale të 3 nëntorit ai i konsideroi një sfidë të rëndësishme për Kosovën.

Pas miratimit të agjendës së takimit të pranishmëve iu drejtua kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi.

Në fjalën e tij, kreu i legjislacionit tha se nga Takimi i Pestë ndërparlamentar midis Parlamentit Evropian dhe Kosovës, që u mbajt vitin e kaluar, institucionet e Kosovës kanë vazhduar të jenë të angazhuara për zbatimin e agjendës evropiane, duke adresuar prioritetet e identifikuar në Raportin e Fizibilitetit të vitit të kaluar dhe aktualisht ato të Raportit të Progresit të tetorit të këtij viti. Krasniqi tha se gjatë këtij viti partneriteti i Bashkimit Evropian me Kosovën ka shënuar ngritje.

"Kosova tashmë ka hyrë në procesin e marrëdhënieve kontraktuale me Bashkimin Evropian. Bashkimi Evropian është pajtuar të nisë dhe sapo kanë filluar negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Kosovën, e cila besoj se do të arrihet shpejt, duke i hapur kështu vendit tonë perspektiva të reja drejt integritit evropian", theksoi kreu i Kuvendit, ndërsa shtoi se në Kosovë në drejtim të integritit evropian veprojnë disa institucione dhe mekanizma presidencialë, parlamentarë, qeveritarë dhe të shoqërisë civile, që shprehin përkushtimin për këtë aspiratë të vendit tonë.

Kryetari Krasniqi tha se zgjedhjet lokale të 3 nëntorit përbëjnë një test të rëndësishëm të demokracisë së re në Kosovë dhe të unitetit shtetëror të vendit tonë, ndërsa nga rregullsia e tyre do të varen konsiderueshëm edhe zgjedhjet e përgjithshme për nivel qendror që duhet të mbahen vitin e ardhshëm. Kryetari i Kuvendit shtroi nevojën e reformimit të sistemit zgjedhor në Kosovë.

Një tjetër sfidë para institucioneve të Kosovës, Krasniqi e konsideroi edhe forcimin e sundimit të ligjit dhe luftën kundër korrupsionit e krimit të organizuar.

Në vazhdim të fjalës së tij, kryeparlamentari Krasniqi foli edhe për procesin e liberalizimit të vizave dhe lëvizjes së lirë, dialogun midis Kosovës dhe Serbisë, për të zhdukurit dhe nevojën që kjo temë tragjike dhe e dhembshme të shtrohet në tryezën e dialogut midis Kosovës dhe Serbisë.



Kosova ka miratuar ligjet bazike dhe ka ndërtuar një strukturë të re të gjyqësorit dhe të prokurorisë

Duke folur në temën: Progresi i Kosovës drejt integritit evropian, shkëmbimi i pikëpamjeve me Qeverinë e Kosovës, Përfaqësuesin e Lartë për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë dhe Komisionin Evropian, zëvendëskryeministri i Kosovës, Hajredin Kuçi, u ndal në tri çështje kryesore: zgjedhjet lokale, vazhdimin e dialogut me Serbinë, si dhe adresimin e të gjeturave nga Raporti i Progresit.

Kuçi e konsideroi të arritur miratimin e legjislacionit, duke theksuar përkushtimin e qeverisë, si sponsoruese kryesore e projektligjeve,

që ato të jenë funksionale, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe të përballueshme për buxhetin e Kosovës.

Sa i përket sundimit të rendit e të ligjit, zëvendëskryeministri i Kosovës theksoi se Kosova ka miratuar ligjet bazike në këtë fushë dhe ka ndërtuar një strukturë të re të gjyqësorit dhe të prokurorisë. Ai përmendi, gjithashtu, edhe luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë dhe përfaqësues i posaçëm i BE-së, Samuel Zhubogari,

duke folur në emër të Përfaqësuesit të Lartë të BE-së dhe Komisionerit për Zgjerim, u fokusua në procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, zgjedhjet e 3 nëntorit dhe proceset integruese të Kosovës. Në këtë drejtim, ai e konsideroi 2013-ën një vit të mirë për Kosovën, si në aspektin e integritimit evropian të saj, ashtu edhe të dialogut me Serbinë. Ai tha se ky proces ka sjellë ndryshime të qarta në Kosovë. Zhbogar tha se zgjedhjet për nivelin lokal do të mbahen në të gjithë

Kosovën dhe se janë më shumë se zgjedhje. Ai tha se ky proces zgjedhor do të hapë rrugë për institucione legjitime në përputhje me ligjin e Kosovës, në mënyrë që ato të përfaqësojnë siç duhet elektoratin. Ai tha se BE-ja pret zgjedhje të lira e të ndershme, në përputhje me standardet ndërkombëtare, të cilat duhet të pasqyrojnë vullnetin e qartë të popullit. Po në këtë temë foli edhe eurodeputeti Antonio Cancian.



Janë shënuar shumë të arritura, por ato pak po afirmohen

Në diskutimin e tij Hydajet Hyseni theksoi se mesazhi kryesor i angazhimeve në Kosovë është integrimi evropian, por Kosova në këtë aspekt është një rast sui generis. Ky vend është pa dilema për integrim, por ky synim është euforik, do të thotë nuk është sa duhet i operacionalizuar. Tani çështje është si ta bëjmë Kosovën që të funksionojë si Evropë. Kosova ka shënuar shumë të arritura, por ato pak po afirmohen, ndërsa nga kjo ka edhe pasoja. Ai pastaj foli edhe për çështjen e bisedimeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe për pengesat që dalin në këtë proces. Bëhen thirrje për standarde evropiane, por disa nuk duken të jenë evropiane, pra veprohet

me kute të dyfishta.

Znj. Ulrike Lunaçek, duke u ndërlidhur me diskutimin e z. Hyseni theksoi: "Kur është fjala për standarde të dyfishta që u theksuan, disa prej tyre varen nga ju, pse nuk ishit në gjendje të bëni reformën elektorale. Kjo nuk i jep imazh të mirë Kosovës. Pra, nuk është fjala për standarde të dyfishta". Ajo në vijim foli edhe për domosdoshmërinë e luftimit më këmbëngulës të korrupsionit, i cili duhet të denoncohet. Edhe në Austri, tha ajo, ka pasur korrupsion, por ai u zbulua nga parlamentarët.

Procesi zgjedhor kredibil- hap shumë i rëndësishëm drejt BE-së

Takimi pastaj vazhdoi me temën: Reformat e sistemit zgjedhor dhe zgjedhjet e ardhshme lokale. Përkitazi me këtë deputeti Halit Krasniqi theksoi se procesi zgjedhor duhet të jetë kredibil, si një hap shumë i rëndësishëm drejt BE-së. PDK-ja kësaj çështjeje iu ka qasur në këtë mënyrë edhe në Komisionin Qendror Zgjedhor, ndërsa për këtë janë dhënë komplimente nga ekspertë ndërkombëtare dhe vendorë.

Duke u ndërlidhur me këtë diskutim z. Lunaçek theksoi se ka mungesë zbatueshmërie në këtë aspekt. Nëse nuk sendërtohet reforma zgjedhore kjo do të reflektohet dhe do të dëmtojë imazhin e Kosovës. Ajo shfaqti shpresën se në procesin aktual zgjedhor gjërat do të shkojnë mbarë.

Deputetja Suzan Novobërdali në diskutimin e saj theksoi se infrastruktura ligjore është e mirë, por

sfidë paraqitet zbatimi i saj. Ajo vlerësoi se vërehet një mosbesim te qytetarët sa i përket procesit të zgjedhjeve, që vjen si pasojë moszbatimit të premtimeve.

Znj. Doris Pack duke iu drejtuar të pranishmëve tha se Kosova fitoi pavarësinë, por partitë po merren me interesa të tyre partiake. Ajo shtroi pyetjen se si ky vend kaq i ri nuk aktivizohet më shumë për njohje edhe nga pesë vendet tjera të BE-së. Për progresin nuk është fajtor vetëm Ligji Zgjedhor. Angazhimi i denjë i deputetëve nga Kosova do të kontribuonte në përpjekjet që bëhen nga parlamentarët evropianë për të ndihmuar proceset e gjithmbarshme në Kosovë.

Për nevojën e përfundimit të shpejtë të reformës zgjedhore foli edhe deputeti Ahmet Isufi.

Rezultatet e dialogut janë dëshmi se BE-ja, si një fuqi e butë, arrin të trajtojë edhe sfida të ashpra

Diskutimet në temën e dialogut ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, i hapi eurodeputeti Tonine Picula, i cili dha një pasqyrë të luftërave në ish-Jugosllavi dhe marrëveshjeve të arritura ndërmjet popujve. Në këtë funksion, ai u ndal edhe në procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe nevojën për stabilitet e paqe të qëndrueshme në këtë pjesë të Evropës.

Duke folur për bisedimet ndërmjet delegacioneve

nga Prishtina dhe Beogradi, Picula tha se rezultatet e tyre janë një dëshmi se BE-ja, si një "fuqi e butë", arrin të trajtojë edhe sfida të ashpra.

Në trajtimin e kësaj teme kontribuan me diskutimet e tyre edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës: Shaip Muja, Hydajet Hyseni, Halit Krasniqi, Petar Miletiq dhe Ahmet Isufi, si dhe deputetët e Parlamentit Evropian: Lajos Bokros e Doris Pack.



Angazhime për integrim të plotë të komunitetit serb në institucionet e Kosovës

Duke iu referuar kësaj teme, deputeti, Petar Miletiq, vlerësoi se komuniteti serb nuk është integruar plotësisht në të gjitha fushat e jetës, gjë që sipas tij, paraqet problem në kapërcimin e sfidave që kanë të bëjnë me liberalizimin e vizave. Ai u angazhua për integrimin e plotë të këtij komuniteti në institucionet e Kosovës, veçanërisht të pjesës nga veriu i Mitrovicës. Lidhur me këtë, ai shprehu bindjen se kjo do të ndodhë pas zgjedhjeve të tre nëntorit.

Deputeti, Albert Kinolli, ndërkaq, pasi foli për përkushtimin e institucioneve, qendrore dhe lokale, theksoi se riintegrimi dhe riatdhesimi i qytetarëve duhet të jetë sa më i suksesshëm, duke vënë në dukje edhe angazhimin e Kuvendit për mbikëqyrjen e procesit të integritit dhe të riatdhesimit.

Se Kosova ka qenë dhe mbetet e përkushtuar në riintegrimin dhe riatdhesimin e qytetarëve të kthyer, foli edhe deputeti, Fatmir Xhelili. Ai vuri në spikamë zbatimin e rekomandimeve të komisionit në të cilin ai bën pjesë.

Deputeti Eduard Kukan, nga Parlamenti Evropian, ndërkaq, lidhur me këtë u shpreh: " PE e kupton që lëvizja e kufizuar e qytetarëve të Kosovës nuk është e drejtë", por, PE e mbështetë fuqishëm nevojën për të ndryshuar situatën.

Edhe për deputetin, Halit Krasniqi, liberalizimi i vizave është i rëndësishëm së veçantë për qytetarët e

Kosovës. Për këtë ai kërkoi mbështetje të vazhdueshme edhe nga PE-ja.

Deputeti Shaip Muja, vlerësoi se pengimi lëvizjes së lirë për qytetarët e Kosovës është padrejtësi të cilën qytetarët janë duke e ndier me dekada. Ai me këtë rast foli në mënyrë kronologjike për emigrimin e qytetarëve, kryesisht në Evropën Perëndimore, për të cilin ai tha se hovin më të madh e ka arritur në vitet e 90-ta, si pasojë e represionit serb në Kosovë. Sot, tha në vijim ai, me mijëra qytetarë aplikojnë për posedim vizash, ndërsa një pjesë shumë e vogël e tyre arrijnë t'i sigurojnë ato. Sipas, deputetit Muja, nga liberalizimi i vizave përfitojnë vetëm qytetarët e ndershëm të cilët në rast të liberalizimit të vizave nuk do t'i keqpërdorin ato.

Deputetja Vjosa Osmani, ndërkaq, duke i'u referuar Raportit të Progresit për Kosovën, tha se ai do duhej të saktësojë se çfarë duhet bërë institucionet e Kosovës, e jo të flitet në mënyrë të përgjithësuar për obligimet institucionale. Ajo ngriti edhe çështjen e dëbimit të qytetarëve me sëmundje të rënda, për të cilët tha se në Kosovë është i pamundshëm riintegrimi dhe rehabilitimi i tyre. Lidhur me këtë, Osmani kërkoi mirëkuptim më të madh të shteteve që ballafaqohen me raste të tilla. Ajo kërkoi që PE edhe në të ardhmen të mbështesë Kosovën në rrugën e integritit të saj në BE.

Ndihet mungesa e dhënies së informatave të besueshme nga pala serbe për vendndodhjen e personave të zhdukur



Kryetarja e Komisionit për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe për persona të pagjetur, Suzan Novoberdali, në fjalën e saj theksoi se Kuvendi ka miratuar Ligjin për mbrojtjen dhe të drejtat e familjarëve dhe për fatin e të zhdukurve. Mirëpo, ajo shfaq shqetësimin se pala serbe nuk tregon angazhim të duhur për të zbardhur fatin e të zhdukurve. Ndër sfidat në këtë aspekt ajo përmendi faktin se ndihet mungesa e dhënies së informatave të besueshme nga pala serbe për vendndodhjen e personave të zhdukur. Në këtë vështrim ajo kërkoi ndihmën e Bashkimit Evropian, pasi një angazhim frytdhënës në këtë aspekt do të ishte çelës kyç për normalizim të marrëdhënieve Kosovë-Serbi.

Duke marrë pjesë në diskutim deputetja Doris Pack tha se në Raportin e Progresit nuk flitet sa duhet për këtë çështje, duke apeluar se duhet të tregohet se ku janë zhdukur këtë njerëz. Serbia nuk po jep informata, e ky është problem për familjarët. Çështja e të pagjeturve, tha ajo, duhet të merret seriozisht edhe në dialogun Kosovë-Serbi në mënyrë që ky kapitull të përfundojë, sepse kjo është histori e dhembshme dhe do të kujtohet gjatë. Në këtë aspekt duhet të bashkëpunohet edhe me EULEX-in. Deputetja Biserka Kostiq tha se lufta ka lënë pasoja të rënda, ndërsa mosndriqimi i çështjes së të pagjeturve sjell pasoja të rënda dhe afatgjata tek familjarët. Ky problem duhet të zgjidhet, kjo është me shumë rëndësi, ndërsa këtu nuk duhet shikuar kombësia, ose përkatësia fetare. Kjo çështje duhet të ketë prioritet edhe në bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, tha ajo.

Hydajet Hyseni përmendi faktin se sivjet Dita e të pagjeturve është shënuar bashkërisht nga qytetarët pa dallim përkatësie kombëtare. Ndërkaq, duke folur për numrin e të zhdukurve ai tha se 154 prej tyre janë fëmijë. Çështja e të pagjeturve, tha Shaip Muja mund të zgjidhet nëse do të kishte vullnet, mirëpo varret

masive nuk po identifikohen nga ana e Serbisë. Në vijim Vjosa Osmani theksoi se zgjidhja e kësaj çështjeje nuk mund të bëhet nga komisionet, kjo

çështje duhet të shtrohet në tavolinë të bisedimeve ndërmjet Kosovës dhe të Serbisë. Duke marrë pjesë në diskutim kryekuvendari Krasniqi përmendi një fshat, në të cilin 51 veta ishin djegur, por nuk ka pasur përpjekje për t' i identifikuar. Të gjitha mbetjet janë në ndërtesën ku janë djegur ata më shumë se njëherë.

Seanca vazhdoi me temën e forcimit të sundimit të ligjit dhe lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, theksoi se korrupsioni është një ndër sfidat kryesore. Një pengesë në luftimin e tij është mos koordinimi në mes agjencive përkatëse që merren me zbatimin e ligjeve. Mossuksesi në luftimin e reflektohet në mosbesim të qytetarëve ndaj insitucioneve. Në vijim ai tha se Parlamenti i Kosovës ka aprovuar ligjet kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe shpëlarjes së parave. Hap i rëndësishëm është bërë edhe me aprovimin e Kodit Penal, i cili do të ketë ndikim pozitiv.

Antonio Cancian u shpreh optimist për rrjedhat e gjithmbarshme në Kosovë. Ai inkurajon institucionet dhe qytetarët e Kosovës për të shikuar drejt së ardhmes. Në këtë frymë ai me rëndësi të dorës së parë sheh forcimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe shteteve evropiane.

Rexhep Selimi në diskutimin e tij theksoi se lufta kundër korrupsionit mbetet një ndër sfidat kryesore edhe për integrim evropian edhe për zhvillim të Kosovës, duke vlerësuar se ka ngecje të mëdha në luftën kundër tij. Kosova, tha ai, ka nevojë për presion pozitiv që Qeveria t' i kryejë obligimet e saj në këtë aspekt, duke ditur se lufta kundër korrupsionit është në listën e gjatë të përmbushjes së obligimeve të Qeverisë drejt integritimit evropian.

Deputeti Fatmir Xhelili duke i bërë një vështrim monitorimit të ligjeve tha se zhvillimet e mira në performancën e policisë nuk e përcollën Prokurorinë dhe Gjyqësinë. Në këtë vështrim, ai tha se është e nevojshme që Kosova të ndihmohet nga bashkësia ndërkombëtare për shkollimin e kuadrove në këtë fushë.

Takimi i 6-të ndërparlamentar

**30 – 31 tetor 2013
Prishtinë**

DEKLARATË E PËRBASHKËT

nga kryesuesit e delegacioneve

Në fund të takimit të 6-të ndërparlamentar mes Parlamentit Evropian dhe Kuvendit të Kosovës, të mbajtur në Prishtinë më 30 – 31 tetor 2013, të dyja delegacionet:

1. Përgëzuan kryeministrat e Kosovës dhe Serbisë, si dhe Përfaqësuesin e Lartë/Zëvendës-presidentin, për përkushtimin e tyre dhe progresin në dialogun Prishtinë - Beograd, mirëpritën marrëveshjet e fundit në telekomunikacion dhe energji, rikujtuan edhe një herë nevojën për transparencën më të lartë në komunikimin e rezultateve të dialogut dhe për përfshirjen e parlamenteve dhe shoqërisë civile në procesin e zbatimit;
2. Theksuan nevojën për përmirësim madhor në mbajtjen e zgjedhjeve të ardhme lokale dhe nënvizuan nevojën për të garantuar karakterin e tyre të rregullt dhe plotësisht demokratik; shprehën shqetësimin për disa raste të rritjes joproporcionale të njerëzve në listën e votuesve; theksuan se pjesëmarrja e serbëve të Kosovës që jetojnë në veri, gjatë zgjedhjeve të 3 nëntorit, do të jetë provë e rëndësishme drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit; inkurajuan serbët e Kosovës dhe përfaqësuesit e tyre politikë që t'i shfrytëzojnë të gjitha mundësitë që të luajnë një rol konstruktiv në politikë dhe shoqëri, në veçanti duke marrë pjesë në mënyrë të ndërgjegjshme në zgjedhje; shprehën shqetësim lidhur me kërcënimet drejt votuesve serbë, sidomos në veri të Kosovës;
3. Shprehën shqetësim për mungesë në zbatimin e reformave zgjedhore që nga viti 2011, kur qytetarëve të Kosovës iu ishte dhënë një premtim i tillë nga partitë politike;
4. Mirëpritën hapjen e negociatave mes Qeverisë së Kosovës dhe Komisionit Evropian për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) më 28 tetor, sipas vendimit të Këshillit Evropian të qershorit të vitit 2013, i cili miratoi mandatin për negociatën për MSA-në: njohën domethënien e këtij hapi kaq të rëndësishëm për Kosovën në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian;

5. I bënë thirrje institucioneve të Kosovës ta përmirësojnë efektshmërinë, përgjegjësinë dhe paañësinë e organeve të drejtësisë dhe ta respektojnë pavarësinë e tyre; nxitën institucionet që në mënyrë proaktive ta forcojnë sundimin e ligjit, veçanërisht duke përndjekur krimin e organizuar dhe korrupsionin, duke përfshirë edhe ata që gjenden brenda radhëve të tyre; shprehën brengën e tyre rreth mungesës së progresit të rëndësishëm në këto fusha;
6. Përsëritën thirrjen e tyre për përmirësimin e kornizës juridike dhe organizative për mbrojtjen e dëshmitarëve, veçanërisht i rëndësishëm për ndjekjen të rasteve të profilit të lartë;
7. Mbështetën ndjekjen e vazhdueshme të krimeve të luftës në Kosovë; thellësisht ndjenë keqardhje për fatin e personave që ende janë të pagjetur, si dhe viktimave të dhunës seksuale, si pasojë e luftës në Kosovë; vunë në pah se zbardhja e së vërtetës për fatin e tyre dhe përballja me drejtësinë e atyre që janë përgjegjës kërkon reagim të menjëhershëm, si një ndër parakushtet qenësore për paqe në rajon;
8. Inkurajuan përgjegjësinë lokale dhe zotërimin e procesit të pajtimit; konsideruan se institucionet kosovare dhe institucionet serbe do të duhej të ndërmerren hapa të mëtejshëm për të qenë më pranë minoriteteve përkatëse, përfshirë sigurimin e qasjes në të gjitha shërbimet zyrtare në gjuhët e tyre;
9. Theksuan rëndësinë e punës së EULEX-it; i bënë thirrje EULEX-it të rrisë transparencën dhe përgjegjshmërinë e punës së tij; ftuan autoritetet e Kosovës të vazhdojnë të respektojnë mandatin e EULEX-it dhe ushtrimin e pushtetit të tij ekzekutiv deri në krijimin e parakushteve për dorëzim të plotë të kompetencave institucioneve të Kosovës;
10. Theksuan rëndësinë e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës dhe inkurajuan institucionet e Kosovës që të shtojnë përpjekjet në realizimin e prioriteteve të caktuara me Planin e Veprimit për Viza dhe të ndërmerren e zbatohen reformat e domosdoshme; bënë thirrje tek institucionet e BE-së që të vazhdojnë me përsheptimin e procesit të vendosjes së Kosovës në listën e bardhë për viza për zonën e Shengenit;
11. Theksuan se anëtarësimi i Kosovës në organizatat për bashkëpunim rajonal duhet të promovohet dhe inkurajohet nga të gjitha vendet në rajon;
12. Theksuan nevojën e evitimit dhe tejkalimit të pengesave politike e procedurale, që i bëjnë qytetarët e Kosovës të jenë të vetmit në Evropë të privuar nga mundësia e shqyrtimit të ankesave të tyre në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Dita Ndërkombëtare të Demokracisë

Kuvendi i Republikës së Kosovës shënoi sot Ditën Ndërkombëtare të Demokracisë. Me këtë rast nga ora 09:00-16:00, Kuvendi hapi dyert për nxënës, studentë dhe qytetarë, të cilët vizituan ambientet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe patën rastin të takohen me përfaqësues të tyre të zgjedhur.

Para hyrjes kryesore të Kuvendit u hap "Panairi i organizatave të shoqërisë civile". Gjatë hapjes së këtij panairi, fjalë rasti mbajtën nënkryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, si dhe përfaqësues të OSBE-së dhe KIPRED-it.



Glauk Konjufca fillimisht tha se deklarata universale e demokracisë përbën një dokument, i cili për herë të parë dhe në mënyrë eksplicite i dedikohet enkas çështjes së demokracisë. Ai theksoi se në vitin 2007 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi rezolutën e saj 62/7, në të cilën përfshihen pothuajse të gjitha parimet fundamentale të kësaj deklarate të demokracisë, si dhe u vendos që 15 shtatori të kremtohet në gjithë botën si ditë e demokracisë. Konjufca pasi shkëputi disa nga pikat e kësaj deklarate, tha se pika 18 është e rëndësishme së veçantë sa i përket aktivitetit të sotëm që po zhvillohet në Kuvend, duke shtuar se ekzistenca

e një shoqërie aktive civile është thelbësore për funksionimin e demokracisë. "Bashkëpunimi mes Kuvendit dhe shoqërisë civile është në rrugë të mbarë", tha nënkryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, duke përmendur si një lajm të mirë edhe nismën e OSBE-së për mbështetje të bashkëpunimit mes Kuvendit dhe shoqërisë civile në Kosovë.

"Kjo do të kurorëzohet me përpilimin e një deklarate të përbashkët për bashkëpunim mes Kuvendit dhe shoqërisë civile, e cila do t'i paraqitet Kuvendit të miratohet si deklaratë", sqaroi Konjufca.



Elaine Conkievich, drejtoreshë e Departamentit të OSBE-së për Demokratizim, duke lavdëruar veprimin e ndërmarrë nga Kuvendi për shënimin e kësaj dite dhe organizimin e këtij aktiviteti, tha se OSBE-ja është e zotuar dhe e përkushtuar që ta forcojë këtë bashkëpunim që ka, si me Kuvendin e Republikës së Kosovës, ashtu edhe me shoqërinë civile, në mënyrë që të krijohet një modalitet i fuqishëm i përbashkët i punës. "OSBE-ja edhe gjatë këtij viti synon që edhe më tej të ndërtojë raportet, të cilat do të forcohen në bazë të parimit. OSBE edhe më tej do të ndihmojë shoqërinë civile që të marrë pjesë,

qoftë në takime, qoftë në shqyrtimin legjislativ, në mënyrë që të forcohet edhe më tej demokracia", tha ajo.

Albert Krasniqi, nga organizata KIPRED, tha se është shënuar avancim në bashkëpunimin mes Kuvendit dhe shoqërisë civile, ndërsa shtoi se përfshirja e sa më shumë grupeve të interesit gjatë hartimit të ligjeve është vlerë e shtuar për demokracinë, duke kontribuar në ligje sa më cilësore. "Vetëm në këtë mënyrë mund të ndërtojmë demokraci transparente, gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse", tha ai.



Në kuadër të këtij shënimi, në ndërtesën e Kuvendit, u mbajt edhe ceremonia e ndarjes së çmimeve për esenë në temën "Sa dëgjohet zëri im?". Me këtë rast, Medina Gjuraj, nga gjimnazi "Eqrem Çabej" në Prishtinë, mori çmimin kryesor. Ndarjen çmimit e bëri kryetari i Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe

Media, Idriz Vehapi, i cili drejtua të pranishmëve me një fjalë rasti.

"Do të punojmë në vazhdimësi që temat që i ngrit rinia të avancohen dhe të zhvillohen, në mënyrë që demokracia të jetë më kuptimplote dhe gjithëpërfshirëse, si dhe të mos ketë diskriminim të asnjë shtrese të shoqërisë", tha mes tjerash Vehapi.



Pamje nga aktivitetet në
Kuvendin e Kosovës



Dita Ndërkombëtare për Zhdukjen e Varfërisë

“Kuvendi nëpërmjet legjislacionit të miratuar, i ka ingranuar Objektivat Zhvillimore, ashtu siç është përcaktuar me Rezolutën për Deklaratën e Mileniumit”, tha kryekuvendari Krasniqi



Sot, në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Zhdukjen e Varfërisë, u mbajt tryeza lidhur me prioritetet pas vitit 2015, të reflektuara në raportin global me titull: “ Një milion zëra – Botën të cilën duam ” , pjesë e të cilit proces është edhe Kosova, si dhe për popullatën dhe zhvillimet pas 2014-ës.

Me këtë rast foli kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, deputetë të Kuvendit të Kosovës bazuar në konkluzionet e dala nga Konferenca Ndërkombëtare për popullatën dhe zhvillimin pas vitit 2014, që ndërlidhen me të gjeturat dhe rekomandimet e raportit të monitorimit të ligjit për barazi gjinore, si dhe përfaqësues të agjencive zhvillimore të Kombeve të Bashkuara dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Qëllimi kryesor i takimit ishte diskutimi mbi progresin e deritanishëm në arritjen e objektiveve zhvillimore të Mileniumit e të përfshirjes sociale, si dhe sfidat e prioritetet e dala nga konsultimet e bëra për agjendën zhvillimore pas vitit 2015.

“Shpresoj të nxjerrim përfundime të qarta për hapat vijues të veprimeve në sferat të cilat ne si deputetë mund t'i përshpejtojmë deri në përfundimin e afatit të dhënë me Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit, më 2015. Roli aktiv i parlamentit në planifikim të uljes së varfërisë, nxit një pjesëmarrje më të plotë të shoqërisë në zhvillimin ekonomik. Ndonëse Kosova nuk është ende anëtare e barabartë e OKB-së, ne jemi përkushtuar, duke theksuar edhe në Kushtetutë, se do të marrim përsipër aplikimin e konventave dhe protokolleve të OKB-së dhe Këshillit të Evropës. Procesi i “Pas 2015” parasheh ndryshime kualitative për objektiva më të

qëndrueshme zhvillimore. Këtë linjë të interesimit duhet të përcjellim edhe ne si Kosovë, ashtu siç kemi marrë pjesë në konsultimet paraprake”, tha kryekuvendari Krasniqi, gjatë fjalës së tij me rastin e Ditës Ndërkombëtare për luftimin e varfërisë.

Kreu i Kuvendit shtoi se objektivat e qëndrueshme zhvillimore të së ardhmes thërrasin për angazhim më të shtuar, partneritet vendor dhe ndërkombëtar, si dhe mirëpresin përkrahjen ndërkombëtare dhe përcaktojnë vlerësimin e raportimin institucional të progresit kundrejt tyre. Ai theksoi se ato kërkojnë nxjerrjen dhe zbatimin e legjislacionit të nevojshëm për përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarit të Republikës së Kosovës. “Kjo do të thotë punë më efektive në identifikimin e çështjeve drejt përfshirjes më të madhe sociale dhe zhvillimit njerëzor në Kosovë, rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën publike dhe vendimmarrje, qasje në informacion, edukim cilësor, krijim të vendeve të punës, dialog dhe integrim ndërkulturor ndërmjet komuniteteve, respekt për të drejta të njeriut dhe sundim të ligjit”, tha kryetari i Kuvendit duke shtuar se edhe pse përballemi me kufizime financiare dhe buxhetore, me vullnet, vendosmëri e koordinim mund të ketë zgjidhje dhe rezultate për secilën nga sfidat e këtyre objektiveve.

Krasniqi vlerësoi se Kuvendi nëpërmjet legjislacionit të miratuar, i ka ingranuar Objektivat Zhvillimore, ashtu siç është përcaktuar me Rezolutën për Deklaratën e Mileniumit dhe shtoi se pas kësaj Rezolute, Kuvendi ka miratuar edhe të ashtuquajturën “Letra e bardhë” që ka të bëjë me agjendën evropiane të përfshirjes sociale.

“Këto politika zhvillimore e drejtojnë Kosovën më afër familjes evropiane. Si deputetë dhe institucion suprem legjislativ e përfaqësues, ne kemi për detyrë të punojmë për mirëqenie më të mirë sociale, mundësi për punësim, zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe shëndet të mirë për të gjithë”, tha kryekuvendari Krasniqi, duke përmendur faktin se Kosova duhet të vazhdojë t'i ketë si prioritete të larta rritjen ekonomike, luftën kundër varfërisë dhe uljen e papunësisë, barazinë gjinore, edukimin cilësor, shërbimet efikase shëndetësore, qëndrueshmërinë ambientale, përgjegjshmërinë ndaj qeverisjes dhe paqes e sigurisë.

Me këtë rast Krasniqi shtoi se Kuvendi do të vazhdojë të përmbush rolin e tij institucional, duke përpunuar dhe miratuar legjislacionin që përcakton ndryshimet pozitive në vend, ndërkaq inkurajoi deputetët që të shpalosin kapacitetin individual dhe profesional për ndryshim nëpërmjet të mjeteve institucionale dhe të reflektojnë në lidhje me përgjegjësinë personale dhe institucionale, si dhe të marrin iniciativa për veprime të shpejta.

Krejtësisht në fund kreu i Kuvendit, dr. Jakup Krasniqi, theksoi se sfidat dhe prioritetet urgjente me të cilat përballen institucionet e Kosovës, kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të reja të punës, luftën kundër krimit e korrupsionit, formësimin e legjislacionit të duhur dhe adekuat në lidhje me varfërinë, reflektimin e Agjendës për Përfshirje Sociale dhe Objektivave Zhvillimore të Mijëvjeçarit në planifikimet buxhetore dhe në planet e veprimit. “Për këtë qëllim, është me rëndësi që ne të reflektojmë në lidhje me përmirësimin e botëkuptimeve tona institucionale, politike dhe publike. Duke u përqendruar në qëllime zhvillimore, ne jo vetëm që do të përmirësojmë jetën e secilit qytetar, por gjithashtu do të përmirësojmë pozicionimin global të Kosovës”, përfundoi kryekuvendari Krasniqi. Ndërkaq, Andrew Russell, koordinator i agjencive të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, tha se do të vazhdojnë edhe më tej bashkëpunimin me Kuvendin e Kosovës, për të përmirësuar të dhënat nga analizat duke sqaruar fillimisht se Kosova është e përfshirë në konsultimet dhe në kontributin e përpilimit të raportit global, për prioritetet zhvillimore pas vitit 2015.

“Ky takim është një hap më tej, duke dizajnuar ligje dhe politika për të ndërtuar një qasje unike për Kosovën, gjë e cila do t'i sillte Kosovës një të ardhme më të ndritshme, brenda Evropës dhe komunitetit ndërkombëtar”, tha Russell, duke

bërë më tej një prezantim të gjerë të raportit.

Në vijim folën edhe deputetët: Suzan Novobrdali, Teuta Sahatqija, Nazane Breca, Vjosa Osmani, ndërkaq, deputeti Zenun Pajaziti, duke përmbyllur këtë tryezë përmendi disa nga çështjet kryesore dhe përfundimtare të dala nga ky debat. Ai tha se përkundër sfidave të mëdha dhe ngecjeve që theksohen në fillim të këtij raporti, regjioni ynë ka një përparim solid, ndërkaq, çështjet që u shtruan për kategori të veçanta duan angazhim shumë më të madh nga institucionet.

Duke konfirmuar disa nga pikat në përputhje me ato që u theksuan gjatë kësaj tryeze, u theksua se Kuvendi i Kosovës pa dyshim se do të vazhdojë angazhimin e vet, bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtar, në përputhje me Rezoluten e vitit 2008, si dhe të punojë në procesin e arritjeve të objektivave zhvillimore mijëvjeçare.

Pajaziti më tej shtoi se roli aktiv i parlamentit në zhdukjen e varfërisë, me politikat që janë pro planifikimit për uljen e varfërisë nxit një pjesëmarrje më të plotë të shoqërisë në zhvillimin ekonomik. “Për këtë parlamentarët duhet të vazhdojnë të jenë të informuar mirë për proceset në nivel të Kombeve të Bashkuara në agjenden “pas 2015”. Edhe pse Kosova nuk është ende anëtare e organizatave të Kombeve të Bashkuara ne jemi të përkushtuar, duke theksuar se në kushtetuese do t'i marrim përsipër aplikimin e konventave dhe protokolleve të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës. Procesi pas 2015 parasheh ndryshime kualitative për objektiva më të qëndrueshme zhvillimore. Gjetjet dhe rekomandimet e raportit global për agjenden e pas 2015 duhet patjetër të merren parasysh dhe funksionalizohen gjatë procesit të vendimmarrjes, hartimit të politikave dhe legjislacionit, marrë parasysh se prioritetet globale dhe ato për Kosovën janë të ngjashme. Të sigurohet një qeverisje e mirë, sundimi i ligjit dhe mundësi të barabartë për të gjithë qytetarët, me theks të veçantë barazia gjinore, në mënyrë që të realizohen objektivat zhvillimore dhe të fuqizohen mekanizmat e llogaridhënies, qeverisë dhe parlamentit, për të siguruar se angazhimet për zhvillim të qëndrueshëm janë bazuar në nivel lokal dhe në nivel gjithë kosovar”, tha kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Zenun Pajaziti.

Në fund ai tha se Kuvendi duhet të sigurojë llogaridhënie në nivel vendi dhe se parlamentarët duhet të fuqizojnë edhe më tutje partneritetin me shoqërinë civile, sektorin privat, etj.

Deputetja Alma Lama

Për Kryeministrin z. Hashim Thaçi

Me një vendim të Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës , z.Hashim Thaçi është marrë vendim për emërimin e znj. Jasmina Vasiç, zëvendësministre e Forcës së Sigurisë në vend të ish - zëvendës ministrit të më parshëm Sllavisha Filipoviç.

Z. Filipoviç, siç e kam ngritur edhe më herët në Kuvend, është kapur duke dërguar informacione mbi armatimin e FSK-së në një parti politike në Beograd, gjë që ka komprometuar figurën e tij. Ky veprim përbën veprën penale të spiunazhit dhe është shumë komprometuese për këtë zyrtar, i cili pavarësisht se veprimi i tij është zbuluar në ministri dhe është bërë edhe publik, ai vazhdon të rrijë në detyrë. Edhe dokumentet që i kanë shkuar Komisionit për Siguri në Kuvendin e Kosovës, dëshmojnë s informacionet e dekonspiruara kanë qenë të një rëndësie të madhe.

- Cili është motivi i largimit të z. Sllavisha Filioviç nga detyra e zv/ministrit të FSK-së?

- A lidhet ky largim me skandalin e spiunazhit që pëmenda më sipër?

Për Ministrin e Punëve të Jashtme, z. Enver Hoxhaj

Sipas deklaratave të disa zyrtarëve të ndryshëm të qeverisë së Kosovës , ministria e Punëve të jashtme dhe ajo e Punës po bëjnë përpjekje për të nënshkruar një marrëveshje punësimi sezonal me shtetin e Katarit. Sipas këtyre zyrtarëve qeveria e Kosovës është duke bërë “përpjekje maksimale” që të dërgojë kontingjentin e parë të punëtorëve në Katar në fillim të viti 2014. Eshtë e qartë se marrëveshja është në procesin e negociimit.

- Çfarë përmban draft-marrëveshja, e cila po negociohet?

- Cilat do të jenë kushtet e punës për punëtorët e Kosovës?

- Sa do të jetë numri i përfituesve të kësaj marrëveshje nëse nënshkruhet dhe për çfarë lloj punësh bëhet fjalë?

- A do të jenë edhe gratë dhe vajzat përfituese dhe çfarë garancish jep shteti i Katarit se do të respektohen të drejtat e punëtorëve nga kosova?

Deputetja Hykmete Bajrami

Për Ministrin e Ministrisë së Financave, z. Besim Beqaj (LDK)

Kuvendi i Republikës së Kosovës gjatë votimit të projektligjit për rishikimin e Buxhetit të vitit 2013 ka votuar dy amendamente, (amendamentin 39 dhe amendamentin 42) me implikime buxhetore, gjë që automatikisht do të duhej ta dërgonte rishikimin e buxhetit në leximin e tretë por kjo nuk ndodhi!

- Meqenëse këto amandamente janë obligime të detyrueshme për qeverinë, ku i merr mjetet qeveria për zbatimin e këtyre amendamenteve dhe aprovimin e kujt do ta ketë qeveria për shkurtime buxhetore që duhet t'i bëjë diku për zbatimin këtyre amendamenteve?



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission
www.kqz-ks.org



Për herë parë zgjedhjet do të mbahen në të gjitha komunat e Kosovës.